

**KOMBET E
BASHKUARA**

Tribunali Ndërkombëtar për Lënda Nr.: IT-04-84bis-AR73.1
Ndjekjen Penale të Personave
Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Data: 16 Mars 2011
së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare
të Kryera në Territorin e Origjinali: anglisht
ish-Jugosllavisë prej vitit 1991

NË DHOMËN E APELEVE

Para: Gjyqtarit Patrick Robinson, Kryesues
Gjyqtarit Fausto Pocar
Gjyqtarit Liu Daqun
Gjyqtarit Andréia Vaz
Gjyqtarit Theodor Meron

Sekretari I Gjyqit: Z. John Hocking

Vendim I datës: 16 mars 2011

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

DOKUMENT PUBLIK

VENDIM MBI KËRKESËN PËR ARGUMENTIM GOJOR

Zyra e Prokurorit

Z. Paul Rogers

Avokatët e Ramush Haradinajt:

**Z. Ben Emmerson QC
Z. Rodney Dixon**

Avokatët për Idriz Balajn:

**Z. Gregor Guy-Smith
Zj. Colleen M. Rohan**

Avokatët për Lahi Brahimajn:

**Z. Richard Harvey
Z. Paul Troop**

DHOMA E APELEVE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Dhoma e Apeleve” dhe gjegjësisht “Tribunali”);

DUKE MARRË SHËNIM “Përmbledhjen e Apelit në Emër të Ramush Haradinajt mbi Shtrirjen e Rigjykimit të Pjesërishëm”, të dorëzuar nga Ramush Haradinaj (“Haradinaj”) më 10 shkurt 2011 (“Apeli”) kundër “Vendimit të Aktakuzës së Katërt të Ndryshuar në Formë të Shkurtuar” lëshuar nga Dhoma e Gjyqit II e Tribunalit më 14 janar 2011;¹

DUKE MARRË SHËNIM se Prokuroria ka dorëzuar Përgjigjen e vet konfidenciale më 21 shkurt 2011,² dhe se Haradinaj ka dorëzuar Përgjigjen e tij më 25 shkurt 2011;³

DUKE MARRË SHËNIM se në Përgjigje, Haradinaj kërkon që të caktohet një seancë gojore nga Dhoma e Apeleve për të dëgjuar palët para se të marrë një vendim mbi Apelin, dhe parashtrohet se Apeli ngrit pyetje të reja dhe komplekse që justifikojnë një seancë gojore;⁴

DUKE MARRË SHËNIM se më 3 mars 2011, Prokuroria ka dorëzuar një Përgjigje Shtesë duke kërkuar leje për të dorëzuar parashtresën e saj dhe duke kundërshtuar kërkesën e Haradinajt për një seancë gojore;⁵

DUKE MARRË SHËNIM se në Përgjigjen Shtesë, Prokuroria parashtrohet se Haradinaj nuk ka treguar përse çështjet e ngritura në Apelin e tij nuk mund të adresohen efektivisht me shkrim dhe se kërkesa e tij është e re dhe është dashur të adresohet në Apel;⁶

DUKE MARRË SHËNIM se në përputhje me Rregullën 116 bis (A) të Rregullave të Procedurës dhe Dëshmisë të Tribunalit (“Rregullat”), apelet interlokutore mund të përcaktohen tërësisht mbi bazën e përmbledhjeve me shkrim;⁷

¹ *Prokurori kundër Ramush Haradinajt e te tjerët*, Lënda Nr. IT-04-84bis-PT, Vendim në Formën e Shkurtuar të Aktakuzës së Katërt të Ndryshuar, 14 janar 2011.

² Përgjigja e Prokurorisë në Apelin e Haradinajt mbi Shtrirjen e Rigjykimit të Pjesërishëm, 21 shkurt 2011 (konfidencial). *Shih po ashtu* Përgjigja e Prokurorisë në Apelin e Haradinajt mbi Shtrirjen e Rigjykimit të Pjesërishëm, 22 shkurt 2011 (version public I redaktuar) (“Përgjigja”).

³ Përmbledhje e Përgjigjes në Emër të Ramush Haradinajt mbi Shtrirjen e Rigjykimit të Pjesërishëm, 25 shkurt 2011 (“Përgjigja”).

⁴ *Ibid*, paragrafët 6, 7.

⁵ Mocioni I Prokurorisë për Leje për të Dorëzuar Përgjigje Shtesë dhe të bëjë Përgjigje Shtesë ndaj Përmbledhjes së Përgjigjes së Haradinajt mbi Shtrirjen e Rigjykimit të Pjesërishëm, 3 mars 2011 (“Përgjigja Shtesë”).

⁶ *Ibid*, paragrafët 1, 2.

DUKE MARRË PARASYSH se Dhoma e Apelit do të lejojë një kërkesë për argumentime gojore në apele interlokutore vetëm nëse argumentet e tilla merren të domosdoshme për Dhomën e Apelit për të arritur te një vendim i informuar;⁸

DUKE MARRË PARASYSH se parashtrimet në lutjet me shkrim janë të gjera dhe se informacioni para Dhomës së Apeleve është i mjaftueshëm për t'i mundësuar të arrijë një vendim të informuar;

DUKE GJETUR se një seancë gojore nuk është e domosdoshme në këtë rast;

PËR ARSYET E MËSIPËRME,

I jep **Prokurorisë leje për të dorëzuar një Përgjigje Shtesë, dhe**

MOHON kërkesën e Haradinajt për një seancë gojore.

Bërë në anglisht dhe frëngjisht, duke qenë autoritativ versioni në anglisht.

Sot më 16 mars 2011

Hagë

Holandë

/nënshkrimi/

Gjyqtari Patrick Robinson

Kryesues

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

⁷ Rregulla 116 bis (A) e Rregullave thotë: “Një apel sipas Rregullës 72 apo Rregullës 73 apo apeli nga një vendim i marrë sipas Rregullës 11 bis, Rregulla 54 bis, Rregulla 73 bis (E), Rregulla 77 apo Rregulla 91 do të dëgjohet në mënyrë ekspeditive mbi bazën e materialit original të Dhomës së Gjyqit. Apelet mund të përcaktohen tërësisht mbi bazën e përmbledhjeve të shkruara.” Apeli ishte dorëzuar sipas Rregullës 73 të Rregullave. *Shih Prokurori kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerët*, Lënda Nr.IT-04-84bis-PT, Vendim mbi Aplikacionin në Emër të Ramush Haradinajt për Certifikim në Përputhje me Rregullën 73(B), 3 shkurt 2011, paragrafi 20.

⁸ *Prokuroria kundër Momčilo Krajišnik*, Lënda Nr. IT-00-39-AR73.1, Vendim mbi Apelin Interlokutor të Vendimit mbi Mocionin e Dytë të Mbrojtjes për Shtyerje, 25 prill 2005, paragrafi 4; *Prokurori kundër Ante Gotovina e të tjerët*, Lënda Nr. IT-06-90-AR72.1, Vendim në Apelin Interlokutor të Gotovinės Kundër Vendimit mbi Disa Mocione që Sfidojnë Jurisdikcionin, 6 qershor 2007, paragrafi 8. *Shih po ashtu Ferdinand Nahimana e të tjerët kundër Prokurorit*, Lënda Nr. ICTR-99-52-A, Vendim mbi Mocionin e Apeluesit Jean-Bosco Barayagwiza për Leje për të Paraqitur Dëshmi Shtesë në Përputhje me Rregullën 115, 5 maj 2006, paragrafi 9; *Théoeste Bagosora e të tjerët kundër Prokurorit*, Lënda Nr. ICTR-98-41-A, Vendim mbi Mocionin e Aloys Ntabakuze për Ndërprerje, Ruajtje të Orarit Përmbledhës dhe të Odës Juridike ndaj Dorëzimit të Pakohë të Përmbledhjes së Përgjigjes së Prokurorisë, 24 korrik 2009, paragrafi 22.